

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “WWWZONE” SHPK

### HYRJE

#### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “WWWZONE”sh.p.k eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k).

Bazuar ne akt themelim te shoqerise, me date 28.10.2020, ortaku me identitet sa me poshte harton statutin e shoqerise, bazuar ne nenin 230/2 I ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaretdhe shoqerite tregtare”.

Jemel Tudor, dtl 19-07-1982 lindur ne Torino Itali, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me karte identiteti me Nr Pasaporte AV2379772 permbajtje sa vijon:

#### NENI 2

Shoqeria eshe krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti, Ligjit 9901 dt 14/04/2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

#### NENI 3

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, I perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

### EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

#### NENI 4

Emertimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar eshte “WWWZONE”sh.p.k.

#### NENI 5

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar “WWWZONE”sh.p.k ka seline e saj ne Tirane Njesia Administrative Kashar, Lagjja Yzberisht, Rruga Teodor Keko, Pallati i ri ne zonen kadastrale 3866, nr pasurie 215/135-N22, kati 1

Aktiviteti i shoqerise zhvillohet ne rrethin e Tiranës dhe do te shtrihet ne te gjithë teritorin shtetëror te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### NENI 6

Bar-kafe, vetsherbim, take-away, non stop 24 ore, delivery, tregetim te nargjiles dhe produkte qe lidhen me to, import-eksport. Shoqeria ka te drejten te hape pika te tjera sherbime brenda dhe jashte vendit te lidhe kontrata bashkpunimi me subjekte te ndryshme sipas Legjislacionit te Republikes se Shqiperise.vendit te lidhe kontrata bashkpunimi me subjekte te ndryshme sipas Ligjislacionit te Republikes se Shqiperise.

### NENI 7

Aktiviteti i shoqerise eshte pa afat te caktuar. Per shkaqe e arsye te ndryshme, ajo mund te mbylli kete aktivitet. Kjo do te behet ne perputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit ne fuqi.

## KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

### NENI 8

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontributi i ortakeve I cili zoterohet ne kete menyre:

- Z. Jemel Tudor zoteron 100% e barabarte me nje (1) kuote te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote te kapitali, te gjitha te nenshkruara dhe te paguara, e cila eshte e barabarte me nje vlere nominale prej 100.000 leke (njqind) mije lek.

Sipas kontributit te mesiperm kuotat zoterohen si me poshte:

### NENI 9

Kapitali themeltar mund te shtohet ose zvogelohet, ne varesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

### NENI 10

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise, ose te lihet peng, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### NENI 11

Kapitali themeltar eshte lehtesisht I transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortja, paraardhesi dhe pasardhesit mund te behen ortake ne shoqeri nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara me ligj.

### NENI 12

Shoqeria mund te kete dhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu perfshihen te gjitha sendet e paluajtshme ne sherbim te shoqerise si dhe ato te luajtshme, te cilat kalojne ne pronesi te shoqerise.

## FONDET E SHOQERISE

### NENI 13

Shoqeria percakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues);Fondi reserve;Fonde te tjera, qe mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Madhesia e secilit fond percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tij.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV.

### NENI 14

Shoqeria ka si organe drejtuese:

Administrator te shoqerise jane

1. Z. Erjon Tafa me ID Nr Pasaporte I707130520

Te zgjedhur sipas ligjit per tregetaret dhe shoqerite tregetare per 1 vjet me te drejte rizgjedhje ose lergimit e tyre sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

### NENI 15

Ortakët për administrimin e shoqërisë ose të aktiviteteve të veçanta të saj ka kompetencë të emergjencës ose disa persona të tjerë si administrator të shoqërisë. Kompetencat e administratorëve të mundshëm përcaktohen në aktin e emerimit të tyre.

### NENI 16

Shoqëria nuk merr përsipër veprimet që mund të kryejnë administratorë të tjerë të mundshëm, në marrëdhënie me persona të tretë që i tejkalojnë kompetencat e tyre të përcaktuara në aktin e emerimit.

### NENI 17

E gjithë veprimtaria e shoqërisë administrohet nga administratori i saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

### NENI 18

Administratorët për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe menyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabel, emerojnë një ose disa eksperte kontabel. Emerimi i eksperteve kontabel është i detyrueshëm për rastet e parashikuara me ligj.

## ORTAKET

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET

### NENI 19

- Përcakton politikën tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimet e statutit.
- Emëron dhe shkarkon administratorët dhe përcakton kompetencat e tyre në aktin e emerimit.
- Përcakton shpërblimin e administratorit, të likuiduesit dhe eksperteve.
- Mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët, pasqyrat financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së shoqërisë.
- Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit.
- Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- Vendos për krijimin e filialeve, degeve ose perfaqësive të shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashkëta.
- Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e aktivitetit të shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqërisë vlerësohen me humbje.
- Realizon marrëdhëniet me të rëndësishme financiare dhe ekonomike të shoqërisë me persona të tjerë fizike dhe juridike.
- Të caktojë dhe shkarkojë drejtues teknik sipas drejtimeve të veprimtarisë që do të ushtrojnë shoqëria (me kontrata pune).
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së asamblese.

## MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

### NENI 20

Asambleja mbledhet sa here qe eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesavete shoqerise, ne rastet e percaktuara me ligj, e ne te gjitha rastet jo me pak se nje here ne vit.

Ajo thirret nga administrator ose ortaket.

Thirret me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, ditën, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e dites, e t'u dergohet ortakeve jo me vonë se shtate dite para dates se parashikuar per mbledhje. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble vete ose edhe nga nje person i autorizuar prej tij, ose ortak tjetër.

Administratoret nuk mund te veprojnë si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi jepet per nje mbledhje te asamblese me te njejtin rend dite edhe nese vijon me shume se nje dite. Vendimet merren me shumice te thjeshte vote.

## KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

### NENI 21

Administratoret e shoqerise kane per detyre:

- Te punoje, te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare, sipas politikës tregtare te vendosur nga asambleja e pergjithshme.
- Te perfaqesoj shoqerine tregtare.
- Te kujdeset per mbajtjen e saktedhe te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar; dhe raportin e ecursie se veprimtarise dhe vazhdimesine e saj, se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve dhe paraqit keto dokumenta para asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoj te dhenat e detyrueshme te shoqerisesic parashikohet ne ligj per QKR.
- Te raportoj para asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare.
- Realizon dhe percakton cmimet e punimeve te kryera si dhe te shitjeve te artikujve te tregtuar.
- Nenshkruan kontrate pune me punemarres.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marrdheniet me organe te ndryshme shteterore dhe me persona te tjere fizike dhe juridike, lidh kontrata em te trete.

## DREJTIMI TEKNIK I SHOQERISE

### NENI 22

Per veprimtari ne fusha te vecanta (ne te cilat ligji percakton drejtim nga specialistet te licensuar), shoqeria do te punesoje me kontrata pune specialist te licensuar sipas fushes perkatese.

## MARRDHENIET FINANCIARE

### NENI 23

Shoqeria mund të lidhe kontrata me sektore shtetërore, drejtperdrejt me tregun e lire, si dhe me persona fizike e juridike, vendas ose të huaj.

### NENI 24

Ne marrdheniet kontratore, shoqeria perfaqësohet nga administratori ose nga persona të autorizuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqerine.

### NENI 25

Shoqeria ka të drejtë të plotë të cele llogari likuiduese pranë bankave të vendit ose të huaja në Shqipëri, shtetërore ose private dhe të kryejë veprimet e likuidimit nepermjet tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ka të drejtë të vetfinancohet në leke ose në valute të huaj.

### NENI 26

Shoqeria përgjigjet për kontributet fiskale, afatet e derdhjes së tyre dhe sigurimet shoqërore. Personat e ngarkuar me këto detyra duhet të mbajnë dokumentacinë të rregullt financiar.

Administratori në fund të vitit duhet të dorëzojë në organin tatimor përkatës bilancin e të ardhurave për efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

## MARRDHENIET E PUNESIMIT

### NENI 27

Administratori vendos për personat që do të punësohen në aktivitetin e shoqërisë. Punësimi do të bëhet në përputhje me aftësitë profesionale të punëmarresit.

### NENI 28

Marrdheniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punësimit që lidhet midis paleve, në bazë të Kodtit të Punës dhe akteve ligjore e nenligjore në fuqi. Në kontratë caktohen kushtet e punës, të pagesës, sigurimit në punë, ditëve të pushimit etj.

### NENI 29

Administratori dhe personeli i shoqërisë është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirëmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e shoqërisë në përputhje me ligjin.

### NENI 30

Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masa disiplinore që merren nga administratori. Punonjësi që largohet nga puna duhet të bëjë dorëzimet e detyrues në bazë të aktit me shkrim, pasi të gëjë këto shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

## PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

### NENI 31

Çdo punonjësi i punësuar në shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës. Ai është i detyruar të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i shoqërisë. Për shkelje të tilla dhe për shkelje të legjislacionit në fuqi merren masa të ndryshme sipas ligjit.

## KONFIDENCIALITETI

### NENI 32

Te gjithë personat që do të punesohen në shoqëri janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e dokumentacionit, të informacionit, të njohurive të fituara si dhe të çdo lloj materiali tjetër konfidencial. Ata duhet të adoptojnë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hapjen e këtyre qofte edhe pjesërisht.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

### NENI 33

Te ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve ndaj personave të tretë, kalojnë në dispozicion të ortakeve të shoqërisë.

### NENI 34

Pagesat e personelit behen sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës dhe përqindjeve të tatimit të përcaktuara nga organi administrative.

### NENI 35

Në rast të mbarimit të veprimtarisë së shoqërisë, fitimi I realizuar duke zbritur ose duke shtuar përqindjet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojnë në dispozicion të ortakeve sipas masës së kuotave që zotërojnë në shoqëri.

### NENI 36

Çmimet e shërbimeve të ofruara në shoqëri si dhe ato të tregtimit caktohen në baze të parimeve të ekonomisë së tregut të lirë. Fitimet e realizuara I nënshtrohen tatimit vjetor të përcaktuar në dispozitatë perkatëse ligjore.

## SHPERNDARJA E SHOQERISE

### NENI 37

#### SHKRIRJA

SHOQERIA mbaron me të përfunduar afati I parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të asamblese së përgjithshme, dhe për shkakë të tjera ligjore, falimentimi etj.

### NENI 38

#### LIKUJDIMI

Në rast mbarimi, SHOQERIA duhet të likujdohet, duke iu nënshtuar procedurave të likujdimit. Për të administruar këto procedure, asambleja e përgjithshme e ortakeve emëron një ose disa likuidatore, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin të SHOQERISE, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimin.

### NENI 39

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nëpërmjet formave të thithjes ose të bashkimit.

### NENI 40

Gjatë fazës së likujdimit, përgjegjësia e administratorit dhe likuidatorit është e njëjte.

## DISPOZITA TE FUNDIT

### NENI 41

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimi.

### NENI 42

Mosmarreveshjet ne marredhenie me personat juridike e fizike, vendas e te huaj, zgjidhen me merkuptim, ne te kundert, gjykata kompetente eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

### NENI 43

Cdo gje tjeter ne kete shoqeri I referohet Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

### NENI 44

Shoqeria do te kete vulen e saj. Statuti I shoqerise u miratua nga ortakët dhe u nenshkrua rregullisht prej tij.

## **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "WWWZONE" SHPK**

**Jemel Tudor**

